



**VENDIMIN**

*Nr. 38, Datë 06.03.2017*

**MBI**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI UNIVERS” SH.P.K NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC “KABASH” ME FUQI TË INSTALUAR 5800 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “a”, 39 pika 3 e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, Nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.03.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për licensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec ”Kabash”;

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (Neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

## **Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kabash“ me fuqi të instaluar 5800 KW, për një afat 30 - vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**